



REPUBLIKA E SHQIPERISE
BASHKIA GJIROKASTER

Nr. ~~1111~~ Prot

Gjirokastër më 29.12.2016

KONTRATE PER SHERBIME

Kontrate Publike per kryerjen e sherbimit me objekt;

“Mbikqyrje e punimeve per objektin: “Rikonstruksion i rruges Picar-Kolonje (faza 2)”

E lidhur sot me daten 29.12.2016 ne Bashkine Gjirokastër , mbeshtetur ne vullnetin e lire te paleve , bazuar ne dispozitat e Kodit Civil , Kodit te Procedures Civile, neni 96, Ligjit nr 9643 date 20.11.2006 “Per prokurimin publik” i ndryshuar , bazuar ne Ligjin 8402 “Per kontrollin dhe disiplinimin e punimeve te ndertimit” te ndryshuar, ne UKM nr 03 date 15.02.2001 “Per mbikqyrjen dhe kolaudimin e punimeve te ndertimit” i ndryshuar sipas kushteve te meposhtme:

Neni 1 ; Perkufizime

Autoriteti Kontraktor eshte Bashkia Gjirokastër, përfaqësuar nga Znj.Zamira RAMI kryetare e Bashkise njohur me poshte si “**AUTORITETI KONTRAKTOR**”:

Kontraktuesi eshte operatori ekonomik “ARENA MK” sh.p.k me NIPT L67619801Q me nr licence MK 2892, date 13.06.2016 “Per mbikqyrje dhe kolaudim te punimeve te zbatimit” perfaqesuar nga administratori Z. Endrit Myrtaj tani e tutje te quajtur si “**Kontraktuesi**”.

Neni 2 : Objekti i kontrates

Autoriteti Kontraktor Bashkia Gjirokastër mbi bazen e dokumentacionit qe disponon pas zhvillimit te procedures se prokurimit me vlere te vogel me daten 27.12.2016 dhe shpalljes se fituesit per kete procedure, i beson Kontraktuesit realizimin e sherbimit me objekt “Mbikqyrje e punimeve per objektin: “Rikonstruksion i rruges Picar-Kolonje (faza 2)”

Çmimi i Kontratës

Çmimi i kontratës duhet të jetë çmimi i ofruar në ofertën e Kontraktuesit dhe i pranuar nga Autoriteti Kontraktues.

Neni 4 : Vlera e Kontrates

Vlera totale e kontrates me objekt “Mbikqyrje e punimeve per objektin: “Rikonstruksion i rruges Picar-Kolonje (faza 2)” sipas ofertes se paraqitur ne tender eshte 60.600 (gjashtedhjetë mijë e gjashtëqinde) leke me t.v.sh .

Cmimi i parashikuar me siper perfshin te gjitha shpenzimet e kontraktuesit per sherbimin ne fjale , si dhe te gjitha detyrimet fiskale ne fuqi.



Neni 5. Kushtet e pageses.

Pagesa per sherbimin duhet bere sipas skedarit te meposhtem:

Pagesa e cmimit te kesaj kontrate do behet nga Autoriteti Kontraktor ne monedhen Lek nepermjet Bankes Kombetare Tregetare, ne llogarine e Kontraktuesit Nr.516000361 me IBAN **AL7020511667000361CLPRCLALLB**

Pagesa do ti behet Kontraktuesit ne baze te perqindjes se situacioneve qe do te paraqiten per likujdim nga ana e shoqerise zbatuese te objektit, brenda 30(tridhjete) diteve nga paraqitja e tyre (situacioneve).

Data e pageses do te jete dita qe fondet debitoohen nga llogaria e Autoritetit Kontraktor. Kur data e mesiperme eshte dite pushimi zyrtar, pagesa do te behet ditën pasardhese te punes.

Kontraktuesi nuk do mare pagese paraprake.

Neni 6 Afati i kontrates

Sherbimi i mbikqyrjes do te zgjate per gjithe periudhen e zbatimit te punimeve, nga momenti i lidhjes së kontratës së sipërrmarjes për zbatimin e punimeve te objektit **“Mbikqyrje e punimeve per objektin: “Rikonstruksion i rruges Picar-Kolonje (faza 2)”** deri në përfundimin e plote te punimeve (perfshire dhe periudhen e garancise) .

Neni 7 Vendodhja e sherbimit

Kontraktuesi do te kryej sherbimin e mbykqyrjes me objekt: **“Rikonstruksion i rruges Picar-Kolonje (faza 2)”**

Neni 8 Siguracioni i Përgjegjesisë Profesionale

Kontraktuesi duhet të mbajë siguracion për përgjegjësi profesionale sipas rregullave dhe praktikave të njohura në përgjithsi për profesionin për ta zhdëmtuar Autoriteti Kontraktues për dëme të rezultuara nga neglizhenca, gabimet ose mangësitë, në kryerjen e Shërbimeve.

Nëse nuk është përcaktuar në kontratë shuma minimale e siguracionit, Kontraktuesi duhet të sigurojë siguracion në shumën e njohur në përgjithësi si të mjaftueshme nën rrethanat e Shërbimeve që po sigurohen.


Neni 9 Te drejtat dhe detyrimet e paleve

Te bien dakort per kushtet qe vijojne:

1. Mbykqyresi i punimeve nuk duhet te jete i lidhur ne asnje menyre me zbatimin e objektit qe do te drejtoje.
2. Menjehere me lidhjen e kontrates autoriteti kontraktor i dorezon mbykqyresit te punimeve informacion dhe dokumentat e objektit per te cilin eshte ngarkuar te kryej mbikqyrjen.
3. Mbikqyresi i punimeve do te vihete ne dijeni nga Autoriteti Kontraktor per nenkontraktoret e mundshem qe zgjedh subjekti zbatues, ne perputhje me kontraten e nenshkuar.
4. Mbikqyresi i sherbimeve pervec sherbimeve te kontrollit per zbatimin e punimeve , duhet te ndjehet edhe grafikun e punimeve.



5. Mbikqyresi i punimeve studion plan-organizimin e punimeve
6. Per objektin qe ndertohet , mbikqyresi i punimeve mban dhe pergjigjet per dokumentacionin percaktuar ne UKM nr 3 date 15.02.2001 "Per mbikqyrjen dhe kolaudimin e punimeve te ndertimit" i ndryshuar.
7. Mbikqyresi i punimeve eshte i detyruar te kontrolloje periodikisht, dhe ne fazen me kryesore, librin e kantierit dhe eshte pergjegjes per saktetin dhe vertetesine e dokumentave qe pasqyrohen ne te si dhe cilesine e punimeve te ndertimit.
8. Ne castin e fillimit te punimeve , mbykqyresi i punimeve duhet te beje verifikimet paraprake si meposhte:
 - Konstatimi i ndryshimeve qe mund te kene ndodhur ne vendin ku do te zbatohet vepra, qe nga koha e projektimit e deri ne momentin e fillimit te punimeve.
 - Verifikimin e te gjithe dokumentacionit perkates, te licencave, te autorizimeve dhe te lejeve te cilat, sipas dispozitave ne fuqi, duhen te meren para fillimit te punimeve;
 - Verifikimin e sheshit te ndertimit, nese eshte i lire dhe i gatshem per te filluar punimet;
 - Njohjen me hollesi te kontrates te sipermarrjes lidhur midis autoritetit kontraktor dhe subjektin zbatues si dhe te gjitha akteve administrative qe lidhen me te, si dhe njohjen e te gjitha ndryshimeve te mundshme te kesaj kontrate me kalimin e kohes;
 - Vendosjen e tabelës së indentifikimit me të dhënat e mëposhtme;
 - a) Emertimi i objektit;
 - b) Data e marjes së lejes së ndertimit;
 - c) Investitori;
 - d) Projektuesi;
 - e) Subjekti zbatues dhe drejtuesi teknik;
 - f) Mbykqyresi;
 - g) Afati i ndertimit;
 - h) Siperfaqja e ndertimit;
10. Mbikqyresi i punimeve, pas verifikimeve te percaktuara ne piken 9 (pjesa e 1) te U.K.M. nr 3 dt 15.02.2001 , te ndryshuar , duhet te hartoje dokumentacionin e meposhtem;
 - Aktin e dorezimit te sheshit te ndertimit shoqerise sipermarese;
 - Aktin e dorezimit nga subjekti zbatues te dokumentacionit teknik dhe administrativ, si licenca autorizime e leje te marra nga subjekti zbatues;



- Shkresen me ane te se ciles njofton Autoritetin Kontraktor per fillimin e punimeve;
11. Mbikqyresi i punimeve , gjate zbatimit te objektit,i jep instruksione dhe urdhera, me shkrim subjektit zbatues sa here qe e sheh te nevojshme, ne zbatim te akteve ligjore e nenligjore dhe ky i fundit eshte i detyruar ti respektojte ato , por duke ruajtur te drejten ti beje me shkrim Autoritetit Kontraktues verejtjet e tij, per instruksionet dhe urdherat e mbykqyresit te punimeve.
 12. Mbikqyresi i punimeve ka te drejte te propozoje largimin nga puna te nje ose te disa personave nga personeli i subjekti zbatues.per te realizuar kete , ai i drejtohet me shkrim titullarit te shoqerise zbatuese , duke i shpjeguar arsyet.Arsyet kryesore te propozimit per largim munde te jene moszbatimi i standarteve dhe i rregullave teknike, mosbindja , paaftesia , arbitrariteti ne zgjidhjen e problemeve teknike ose pakujdesi te renda.
 13. Mbikeqyresi i punimeve ka te drejte te kerkoje kryerjen e provave te materialeve per te verifikuar cilesine e tyre Materialet qe vijne ne kantier duhet te jene ne perputhje me kerkesat teknike te porjektit . materialet ne veper perdoren vetem me miratimin e mbikeqyrsit te punimeve . Materialet e ardhura si dhe pajisjet e siguruara nga subjekti zbatues por qe nuk pranohen nga mbikeqyresi , zevendesohen me te tjera , me shpenzimet e subjektit zbatues. Ne keto raste(si per materialet ashtu edhe per pisjet) mosparnimi duhet dokumentuar me procesverbalet e analizave te provave sebashku me aktin teknik, ku te argumentohen shmangiet e palejuara, referuar standarteve te detyrueshme shqiptare ose atyre europiane.
 14. Mbikëqyrësi i punimeve ka të drejtë të kërkojë kryerjen e provave të materialeve të vendosura në objekt, kur këto nuk janë kryer në masën, sipas vëllimeve të realizuara dhe pjesës së lëndës së parë të furnizuar, për të verifikuar cilësinë. Shpenzimet për këto prova janë në ngarkim të subjektit zbatues(sipërmarrësit).
 15. Kur mbikëqyrësi i punimeve mendon se ka defekte në zbatimin e punimeve, kërkon verifikimet përkatëse. Kur verifikimet i japin të drejtë mbikëqyrësit të punimeve, shpenzimet janë në ngarkim të subjektit zbatues (sipërmarrësit), në rast të kundërt, subjekti zbatues (sipërmarrësi) ka të drejtë të kërkojë shlyerjen e shpenzimeve.
 16. Mbikëqyrësi ka të drejtë të pezullojë, përkohësisht, punimet për zbatimin teknik të gabuar ose paaftësi teknike zbatimi, në çdo rast me miratimin e investitorit, për aq kohë sa quhet e nevojshme korrigjimi i gjendjes.
 17. Mbikëqyrësi i punimeve kontrollon zbatimin e grafikut të hollësishëm të punimeve dhe i raporton çdo muaj investitorit për realizimin e tij. Asnjë punim nuk do të mbulohet, maskohet a betonohet pa miratimin e mbikëqyrësit të punimeve. Subjekti zbatues (sipermarresi) duhet të njoftojë mbikëqyrësin kur punimet janë gati për t'u ekzaminuar prej tij.
 18. Mbikëqyrësi i punimeve mban dosjen e mbikëqyrjes së punimeve, ku pasqyrohen të gjitha aktet e mbajtura gjatë zbatimit të objektit, që nga akti i dorëzimit të sheshit të ndërtimit, urdhrat e ndryshme që ai ka dhënë gjatë zbatimit të objektit, kundërshtitë dhe kontradiktat e lindura gjatë punës, ndërprerjet e punimeve dhe shkaqet që kanë diktuar këto ndërprerje, relacionet teknike, të kërkuara ose të paraqitura gjatë zbatimit, si dhe të gjitha rrethanat e nevojshme për të dhënë kuadrin e plotë të të gjitha fazave të zbatimit të



punimeve. Kete informacion te detajuar mbikeqyresi I punimeve eshte I detyruara t'ja raportoje Autoritetit Kontraktues.

19. Në rastin e ndërrimit të mbikëqyrësit të punimeve, mbahet procesverbal i dorëzimit të dosjes së punimeve, ku shënohen edhe shkaqet e këtij ndërrimi. Dokumentacioni i mbikëqyrësit të vjetër i dorëzohet mbikëqyrësit të ri. Investitori mund të kërkojë largimin dhe zëvendësimin e mbikëqyrësit, kur vërtetohen mangësi serioze në veprimtarinë e tij, si:

- Mangësi në plotësimin e detyrave të përcaktuara në pikën 1 të këtij udhëzimi.
- Ndërprerje e paarsyeshme e punimeve dhe zgjatje e theksuar e tyre.
- Mangësi kontrolli në kosto e kontabilitet, tolerim i materialeve me vlera mbi ato të preventivuara ose jo me cilësi.

20. Me përfundimin e punimeve, brenda 30 ditëve, mbikëqyrësi i punimeve duhet t'i kerkoje me shkrim subjektit zbatues qe te paraqese:

a. Kontratën dhe aktet që lidhen me të.

b. Regjistrimin e kontabilitetit.

c. Procesverbalet e fillimit, të ndërprerjes ose të zgjatjes dhe të përfundimit të punimeve.

ç. Certifikatat e provave të materialeve të përdorura, të lëshuara nga laboratorët e autorizuar për këtë qëllim.

d. Deklaratë se objekti është ndërtuar në përputhje me projektin dhe me kushtet teknike.

Për të gjitha problemet e verifikuara prej tij, mbikëqyrësi i punimeve duhet të firmosë gjithçka që ka miratuar. Ai mban përgjegjësi ligjore, së bashku me subjektin zbatues (sipermarresin). Një kopje e dokumentacionit, e miratuar nga mbikëqyrësi i punimeve, i dërgohet kolaudatorit të objektit.


21. Mbikëqyrësi i punimeve merr pjesë në kolaudimin e veprës, i përgjigjet kolaudatorit me të gjithë dokumentacionin e nevojshëm për kolaudimin e veprës, si dhe firmos procesverbalin e këtij kolaudimi.

22. **Situacionet mujore pjesore, progresive dhe përfundimtare e paraqitura nga subjektin zbatues, (sipermarresi) hartohen mbi bazën e volumeve të llogaritura në librezën e masave dhe kontrollohen dhe miratohen nga mbikëqyrësi i punimeve i cili mban përgjegjësi ligjore për saktësinë e tyre. Paga mund të kryhet vetëm në bazë të këtij miratimi. Këto dokumente dërgohen në sektorin financiar të punëdhënësit, bashkë me vërtetimin e përkohshëm të pagesës, për të shpallur vlerën e detyrueshme për pagim.**

23. Pas përfundimit të kolaudimit, mbikëqyrësi i punimeve, mbështetur në kontratën dhe në dokumentacionin tjetër, përcakton vlerën përfundimtare të objektit, e cila i bëhet e ditur subjektin zbatues (sipermarresit), si dhe i jepet për likuidim Autoritetit Kontraktues (investitorit.).

24. Mbikëqyrësi i punimeve kontrollon dhe autorizon përdorimin e fondit rezervë, të preventivuar, dhe i raporton, periodikisht, Autoritetit Kontraktues (investitorit) për gjendjen e tij. Ky i fundit, nëse ka vërejtje, e njofton subjektin zbatues (sipermarresin) dhe problemi zgjidhet ndërmjet tyre. Për çdo ndryshim të mundshëm, mbikëqyrësi i punimeve vihet në dijeni, për të ndjekur zbatimin e ndryshimeve në fjalë.

25. Autoriteti Kontraktor nuk i bën pagesën mbikeqyresit te punimeve nese konstaton se nuk jane respektuar dispozitat ligjore dhe nenligjore per realizimin e kontrates dhe mbikeqyrjes se punimeve



26. Ne perfundim te periudhes se garancise Autoriteti Kontraktor , Kolaudatori, mbikeqyresi dhe zbatuesi i punimeve duhet te bejne kontrollin perfundimtar te vepres. Per defektet qe nuk jane ndrequr gjate periudhes se garancise se punimeve te ndertimit Autoriteti Kontraktues llogarit koston e ndreqjes se tyre dhe ben ndalesen nga vlera e garancise se punimeve.
27. E gjithë korrespondenca e mbikëqyrësit të punimeve me investitorin dhe me sipërmarrësin, përbën dokumentacionin e objektit dhe, si e tillë, ruhet me çdo kusht
28. Kur vërehen shkelje të rënda të dispozitave ligjore, Autoriteti Kontraktor ose dikasteri nga varet ky Autoritet Kontraktor , si dhe Inspektoriat ndertimor e Urbanistik vendor/kombetar , kanë të drejtë të urdhërojnë mbikëqyrësin e punimeve për ndërprerjen e punës, deri në marrjen e masave përkatëse, për normalizimin e gjendjes..
29. Kur shkeljet e dispozitave ligjore mund të përbëjnë kundërvajtje administrative, vendosen sanksione, në bazë të neneve 15 dhe 16 të kreut III të ligjit nr.8402, datë 10.9.1998, "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit".i ndryshuar
30. Mbikeqyresi I punimeve mban pergjegjesi ligjore per mosrespektin te kushteve te kesaj kontrate dhe akteve ligjore dhe nenligjore ne fuqi.

Neni 10 Dispozita te fundit.

Kontrata hyn ne fuqi ne momentin e nenshkrimit te saj nga palet.

Palet e kesaj kontrate duhet të bëjnë çdo përpjekje të zgjidhin mosmarrëveshjet ose konfliktet e ndodhura midis tyre ose në lidhje me këtë marrëveshje me negociata direkte.

Nëse palët dështojnë në zgjidhjen e mosmarrëveshjes ose konfliktit, problemet do të konsiderohen me anë të zgjidhjes së marrëveshjeve sipas kontratës dhe procedurave juridike në fuqi sipas legjislacionit të Republikës së Shqipërisë.

AUTORITETI KONTRAKTOR
BASHKIA GJIROKASTER



KONTRAKTUESI

"ARENA MK" sh.p.k
Perfaqesuar nga administratori

ENDRIT MYRTAJ

